



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 897/12 prot.,

Datë 08.05.2026

V E N D I M

Nr. 614/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.527/2026, datë 22.04.2026, në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me Nr. REF-76259-02-16-2026, me objekt: “Ndërtim mur mbajtës për segmentin rrugor të lagjes Xhete, fshati Boçeve, Nj.Adm. Shupenzë, Bashkia Bulqizë” me fond limit 2 244 708 (dy milion e dyqind e dyzetë e katër mijë e shtatëqind e tetë) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
- Ankimues:** OE “SHEHU” SHPK me NIPT J66702707S dhe me adresë, Maqellare Diber Maqellare, MAQELLARE, Ndertesa 1-kateshe, me zone kadastrale nr. 2592 dhe me nr. pasurie 440, ne rrugen nacionale Peshkop.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Bulqizë me adresë Lagja Minatori, Bulqizë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 22.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.527/2026, ku vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shehu” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thejshuar”, me Nr. REF-76259-02-16-2026, me objekt: “Ndërtim mur mbajtës për segmentin rrugor të lagjes Xhete, fshati Boçeve, Nj.Adm. Shupenzë, Bashkia Bulqizë” me fond limit 2 244 708 (dy milion e dyqind e dyzetë e katër mijë e shtatëqind e tetë) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.*
- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Shehu” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operatorë ekonomik.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shehu” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 2090/1 prot., datë 29.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 897/9 prot., datë 04.05.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Bulqizë, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 527/2026, datë 22.04.2026.
-bashkëlidhur, vlerësimi i printuar nga SPE dhe raporti përfundimtar;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën përcjellëse me nr. 2090/1 prot., datë 29.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 897/9 prot., datë 04.05.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Bulqizë, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 527/2026, datë 22.04.2026.
-bashkëlidhur, vlerësimi i printuar nga SPE dhe raporti përfundimtar;

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 2090/1 prot., datë 29.04.2026, protokolluar me tonën me

nr. 897/9 prot., datë 04.05.2026, nëpërmjet shërbimit postar, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.527/2026, datë 22.04.2026, duke rivlerësuar arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik “Shehu” Shpk. KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik, duke rivlerësuar këtë subjekt ofertues dhe pas rivlerësimit statusi nga “I skualifikuar” është ndryshuar në statusin “I kualifikuar”, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar, duke bashkëlidhur edhe vlerësimin e printuar nga SPE dhe raporti përfundimtar të gjeneruar nga anëtarët e KVO-së.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike*”, me Nr. REF-76259-02-16-2026, me objekt: “Ndërtim mur mbajtës për segmentin rrugor të lagjes Xhete, fshati Boçeve, Nj.Adm. Shupenzë, Bashkia Bulqizë” me fond limit 2 244 708 (dy milion e dyqind e dyzetë e katër mijë e shtatëqind e tetë) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

